



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA KUSHTETUESE
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT

Nr. 2-8/2021 regjistri (JD)
Datë. 08.02.2022

Nr. 3 i vendimit
Datë 03. 10. 2022

VENDIM
I KOLEGJIT TË SHQYRTIMIT PARAPRAK

Kolegji i Shqyrtimit Paraparak i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, i përbërë nga:

Natasha Mulaj	Gjyqtare
Rezarta Schuetz	Gjyqtare
Sokol Çomo	Gjyqtar

mori në shqyrtim paraparak në dhomë këshillimi mbi bazë aktesh, më datë 03.10.2022, në ambientet e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, çështjen e Juridiksionit Disiplinor (JD) nr. 2-8/2021, datë 08.02.2022, që i përket:

KËRKUES: Hasan Roqi

SUBJEKTE Inspektorati i Lartë i Drejtësisë
TË INTERESUARA: Këshilli i Lartë Gjyqësor
Këshilli i Lartë i Prokurorisë

OBJEKTI:

1. Saktësim i të metave i Vendimit nr. 1, datë 17 janar 2022, të Gjykatës Kushtetuese, Kolegji i Posaçëm i Apelimit.
2. Plotësim i Vendimit nr. 1, datë 17 janar 2022, të Gjykatës Kushtetuese, Kolegji i Posaçëm i Apelimit.
3. Sqarim dhe interpretim i Vendimit nr. 1, datë 17 janar 2022, të Gjykatës Kushtetuese, Kolegji i Posaçëm i Apelimit.
4. Pezullim i nenit 102 të ligjit nr. 96/2016, të ndryshuar me ligjin nr. 48/2019, i cili ka shfuqizuar pikat 4 dhe 5 të ligjit nr. 96/2016, duke shkelur votën e 140 deputetëve të reformës në drejtësi, duke cenuar interesat e kërkuarit, ta sjelli përmbajtjen e ligjit në formë të arsyeshme dhe të pranueshme juridike, në shërbim të shtetasve shqiptarë dhe jo të burokratëve magjistratë, të ILD-së, KLGj-së dhe KLP-së, të pangopur e shkelës së Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe GjEDNj-së, për rehatinë e tyre personale.
5. Të gjendur para një gjykimi të hapur transparent publik, publikimin e kësaj kërkesë, për publikun shqiptar, pranë vendimit nr. 1, datë 17 janar 2022, të Gjykatës Kushtetuese, Kolegji i Posaçëm i Apelimit, deri në saktësimin, plotësimin dhe sqarimin e

vendimit të saj, pezullimin e nenit 102 të ligjit nr. 96/2016, të ndryshuar me ligjin nr. 48/2019, si më sipër nga ana e Gjykatës Kushtetuese, Kolegji i Posaçëm i Apelimit.

6. Shqyrtimin e çështjes në seancë plenare.

BAZA LIGJORE:

- Neni 15, neni 17, pikat 1, 2, neni 18, pikat 1, 2, 3, neni 126, neni 25, neni 37, neni 41, pikat 1, 2, neni 44, neni 122, pikat 1, 2, 3, neni 131, pika 1, shkronja “f”, neni 132, pikat 1, 2, neni 134, pika 1, shkronja “i”, neni 137, neni 179, pika 7, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë;

- Nenet 3, 6.1, 8.1, 13, 14, 41, Protokolli 1 neni 1, Protokolli 16 neni 1, të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut;

- Neni 1, pikat 1, 2, neni 16, neni 25, pika 1, neni 26, pikat 1, 2, 3 (për vendimin nr. 76/2000, të Gjykatës Kushtetuese), neni 31/c, pikat 1 (fjalë e fundit), 2, neni 34, shkronja “c”, neni 38, pika 6, neni 42, pikat 1, 2, 3, neni 44/b, pikat 1, 2, neni 45, pikat 1, 2, 3, 4, 5, neni 48, pika 1, neni 49, pika 3, shkronja “e”, pika 4, neni 50, pika 4, neni 51, pika 1, shkronjat “a”, “b”, neni 54, pikat 1, 2, 3, 4, neni 55, neni 71, pikat 1, 2, 3, neni 71/a, pika 1, shkronjat “a”, “b”, “c”, “ç”, neni 71/b, pikat 1, 2, 3, 4, neni 71/ç, pikat 1, 2, 3, 4, neni 72, pika 7, neni 76, pikat 1, 2, 3, neni 80, pika 1, neni 81, pikat 1, 2, 3, 4, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar;

- Nenet 1, 312, 313, 314, 451/a, Kodi i Procedurës Civile;

- Neni 4, pikat 1, 2, neni 5, neni 11, neni 13, neni 15, neni 24, pika 1, neni 25 i ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”.

Kolegji i Shqyrtimit Paraprak të kërkesës, pasi dëgjoi gjyqtaren relatores Natasha Mulaj, shqyrtoi kërkesën dhe dokumentet shoqëruese të saj, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

1. Pranë Kolegjit të Posaçëm të Apelimit (në vijim “Kolegji”) është administruar kërkesa e paraqitur nga kërkuesi Hasan Roqi, me nr. {***} prot., datë 08.02.2022, i cili ka kërkuar saktësimin, plotësimin, sqarimin dhe interpretimin e vendimit nr. 1, datë 17.01.2022, të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, pezullimin e nenit 102 të ligjit nr. 96/2016, të ndryshuar me ligjin nr. 48/2019, i cili ka shfuqizuar pikat 4 dhe 5 të ligjit nr. 96.2016, publikimin e kësaj kërkesë pranë vendimit nr. 1, datë 17 janar 2022, në faqen zyrtare të Gjykatës Kushtetuese dhe shqyrtimin e çështjes në seancë plenare.
2. Kolegji i Shqyrtimit Paraprak, në vendimin nr. 1, datë 17.01.2022, ka konstatuar se pretendimet e kërkuarit në çështjen e juridiksionit nr. 8/2021, datë 15.10.2021, janë jashtë juridiksionit dhe kompetencës së Kolegjit dhe bazuar në nenin 31, nenin 31/a, pika 2, germat “a” dhe “b” të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, ka vendosur moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.

I. Pretendimet e kërkuessit

3. Kërkuessi pretendon se, lidhur me vendimin nr. 1, datë 17.01.2022, në rubrikën “Rrethanat e çështjes”, në paragrafin 6, gjykata në të njëjtën mënyrë si magjistratët e proceduar për shkelje disiplinore nga kërkuessi, ashtu si dhe vendimmarrjet e institucioneve të ILD-së, KLGJ-së dhe KLP-së, vendimet e të cilave janë ankuar në Kolegj nga kërkuessi, nuk kanë pasqyruar asnjë nga arsyet dhe rrethanat e vërteta që kanë çuar kërkuessin dhe familjarët e tij të ushtrojnë 2 (dy) ndjekje penale me objekte dhe subjekte të ndryshme, të përshkuara qartë në kërkesën e kërkuessit drejtuar Kolegjit.
4. Kërkuessi pretendon se në paragrafin nr. 8, të vendimit nr. 1, datë 17 janar 2022, Kolegji, në të njëjtën mënyrë si vendimet e ankimura të ILD-së, KLGJ-së dhe KLP-së, nuk ka dhënë asnjë arsye, përse kërkuessi i ka proceduar për shkelje disiplinore magjistratët znj. D. M., znj. S. D., z. Dh. L. dhe z. S. B. (sot anëtar i Gjykatës së Lartë dhe kryetar i Këshillit të Emërimeve në Drejtësi për të bërë më të qartë veprimet e tyre, ku përgjegjësia e çdo magjistrati është individuale dhe jo kolektive. Sipas kërkuessit vendimet e tyre janë haptazi në kundërshtim me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, Kodin e Procedurës Penale, ligjin nr. 8577/2000, si dhe me KEDNj-në.
5. Në kërkesën e tij, datë 08.02.2022, drejtuar Kolegjit, kërkuessi, pasi rendit një sërë shkeljesh të kryera, sipas tij nga prokurorja znj. D. M. dhe nga magjistratët znj. S. D., z. Dh. L. dhe z. S. B., veprime këto të ardhura pas 2 (dy) kallëzimeve të kryera nga ana e tij pranë SPAK-ut, kërkon që shkeljet e rënda disiplinore të kryera nga kjo prokurorë dhe nga këta magjistratë të pasqyrohen emër për emër në vendimin nr. 1, datë 17 janar 2022, të Kolegjit.
6. Kërkuessi kërkon që Kolegji të pezullojë nenin 102 të ligjit nr. 96/2016, të ndryshuar me ligjin nr. 48/2019, ku u mbështet në vendimin e tij për moslegjitim dhe moskompetencë në vendimin nr. 1, datë 17.01.2022. Sipas kërkuessit shfuqizimi i pikave 4 dhe 5, të nenit 102 të ligjit nr. 96/2016, ka sjellë kontradiktë në legjislacion, është haptazi në shërbim të shkeljeve disiplinore të magjistratëve dhe jemi para një ndryshimi antikushtetues të paramenduar. Sipas kërkuessit, ky ndryshim i nenit 102 të ligjit nr. 96/2016 me ligjin nr. 48/2019, ka sjellë shkeljen e të drejtave të kërkuessit, i cili kërkon nga Gjykata Kushtetuese, Kolegji, në bazë të nenit 45, pikat 1, 2, 3, 4, 5, të ligjit nr. 8577/2000, të gjejë autorët të cilët i kanë propozuar Kuvendit këtë ndryshim, të fillojë procedimin për përkrahje të krimit të organizuar, t’i japë një gjobë të rëndë autorëve dhe t’i flakë nga sistemi. Kërkuessi kërkon nga Gjykata Kushtetuese të pezullojë nenin 102 të ligjit nr. 96/2016, të ndryshuar me ligjin nr. 48/2019 e ta sjellë përmbajtjen e ligjit në formë të arsyeshme dhe të pranueshme juridike, në shërbim të shtetasve shqiptarë.
7. Gjithashtu, në kërkesën e tij, kërkuessi interpreton dispozita të ndryshme ligjore, për të konfirmuar legjitimitetin e tij dhe kompetencën e Kolegjit, në shqyrtimin e kërkesave të tij të trajtuara me vendimin nr. 1, datë 17.01.2022, të Kolegjit.

II. Vlerësimi i Kolegjit të Shqyrtimit Paraprak

8. Kolegji i Shqyrtimit Paraprak sjell në vëmendje që pas shpalljes së vendimit nr. 1, datë 17.01.2022, (JD) të Kolegjit, ky vendim nuk mund të anulohet ose të ndryshohet. Në mënyrë përjashtimore, një vendim mund të saktësohet ose plotësohet kur ekzistojnë rrethanat e parashikuara në nenin 80 të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.

9. Lidhur me pretendimin e kërkuarit për pezullimin e nenit 102 të ligjit nr. 96/2016, të ndryshuar me ligjin nr. 48/2019, Kolegji i Shqyrtimit Paraprak vlerëson se kjo kërkesë është tërësisht e pabazuar, jashtë juridiksionit dhe kompetencës së këtij Kolegji.
10. Në lidhje me pretendimet e tjera të kërkuarit, Kolegji i Shqyrtimit Paraprak çmon se këto pretendime janë të pabazuara, pasi në rubrikën e numërtuar I, “Rrethanat e çështjes” dhe në rubrikën e numërtuar II, “Pretendimet e kërkuarit”, të vendimit nr. 1, datë 17.01.2022, të Kolegjit, janë cituar në mënyrë të përmbledhur rrethanat, faktet dhe kërkimet e tij, referuar kërkesës drejtuar Kolegjit.
11. Në përfundim, Kolegji për Shqyrtimin Paraprak çmon se kërkesa e kërkuarit për saktësimin dhe plotësimin e vendimit nr. 01/2022, datë 17.01.2022, të Kolegjit, nuk bazohet në ekzistencën e ndonjë gabimi në shkrim ose ndonjë pasaktësi të dukshme, por bazohet në pretendime dhe kërtime, të cilat ndryshojnë thelbin e vendimmarrjes së Kolegjit, në kundërshtim me nenet 75, 76, pika 1 dhe 80 të ligjit nr. 8577/2000, për rrjedhojë kërkesa e kërkuarit është e pabazuar në fakte dhe në ligj dhe, si e tillë, duhet të rrëzohet.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji i Shqyrtimit Paraprak të kërkesës, bazuar në nenin 31 dhe nenin 80 të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

VENDOSI:

Rrëzimin e kërkesës së kërkuarit Hasan Roqi.

Tiranë, më 03.10. 2022.

Sokol ÇOMO

Natasha MULAJ

Rezarta SCHUETZ

ANËTAR

ANËTARE

ANËTARE

nënshkrimi

nënshkrimi

nënshkrimi